
VIKTORIAN ERA AND THE “CRITICAL” REALISATION

Suzana Ibraimi Memeti

State University of Tetovo, North Macedonia, suzana.ibraimi@gmail.com

Abstarct: This paper provides an explanation of the term "Victorian" that was created shortly after the First World War. This term has remained in daily use and implies Victorianism in its entirety as a kind of period of domination of "micro-bourgeoisie". The Industrial Revolution brought and consolidated the factory system and the new capitalist class of society, industrialists, on the one hand, and the working class, on the other hand, which became the two dominant classes of society in sharp contrast to one another. These new features gave British society the stamp that until then had been a bourgeois-aristocratic hybrid society. For such a bourgeois society, at the peak of its development has been characteristic and rapid development of science and technology, which has greatly influenced the formation of a new social ideology. Regarding this, Darwin's biological research results had a greater impact on it. Throughout this period, there were also reactions to different intelligence views. Some aspects of these reactions have exerted ideological influence on literature. For such society, the rapid development of science and technology was characteristic of its development, which has also influenced the formation of a new social ideology. Overall, we can say that "Victorianism" is an ideological complex issue of English Bourgeoisie, in the era when England reached the highest points of its power. In addition to the aristocracy and the old commercial and financial bourgeoisie, intelligence and intellectuals were present. The Victorian period was an era of paradoxes. It was an era of religion and against religion, an era of progress and optimism, and an era of poverty and pessimism, an era of "male rule" but also an era of emancipation of women. In addition to these paradoxes, it was also a "par excellence" era of the novel.

Keywords: Victorianism, burgeois society, science, aristocracy, Industrial Revolution.

EPOKA VIKTORIANE DHE REALIZIMI “KRITIK”

Suzana Ibraimi Memeti

State University of Tetovo, Macedonia, suzana.ibraimi@gmail.com

Abstrakti: Në këtë punim është dhënë një sqarim rreth termit dhe dukurisë “viktorian/e” që u krijua fill pas Luftës së Parë Botërore. Ky term ka mbetur ende në përdorimin e përditshëm dhe nënkupton viktorianizmin në tërësi si një lloj periudhe të dominimit të “mikroborgjezisë”. Revolucioni industrial solli dhe konsolidoi sistemin e fabrikës dhe shtresën e re kapitaliste të shoqërisë, industrialistët, nga një anë, dhe klasën punëtore, nga ana tjetër, të cilat u bënë dy klasat dominuese të shoqërisë në kundërvënien të mprehtë ndaj njëra tjetrës. Këto karakteristika të reja i dhanë shoqërisë britanike vullën vendimtare e cila deri atëherë kishte qenë një shoqëri hibride borgjeze-aristokratike. Për një shoqëri të tillë borgjeze, në hovin e zhvillimit të saj ka qenë karakteristik dhe zhvillimi i shpejtë i shkencës dhe i teknikës, gjë që ka ndikuar mjaft edhe në formimin e një ideologjie të re shoqërore. Lidhur me këtë, ndikim më të madh patën rezultatet e kërkimeve biologjike të Darvinit. Gjatë tërë kësaj periudhe pati edhe reagime mbi pikëpamjet e ndryshme të inteligjencës. Disa aspekte të këtyre reagimeve kanë ushtruar ndikim ideologjik në letërsi. Në tërësi, mund të themi se “viktorianizmi” është një kompleks ideologjik dhe karakteristik i borgjezisë angleze në epokën kur Anglia arriti pikën kulmore të fuqisë së saj. Përveç aristokracisë dhe borgjezisë së vjetër tregtare dhe financiare, tani ishin të pranishme inteligjenca dhe intelektualët. Periudha viktoriane është një epokë e paradokseve. Ajo ishte një epokë e fesë dhe epokë kundër fesë, një epokë e progresit dhe e optimizmit, dhe një epokë e varfërisë dhe e pesimizmit, një epokë e sundimit të “meshkujve” por edhe një epokë e emancipimit të femrave. Përveç këtyre paradokseve ajo ishte edhe një epokë “par excellence” (e shkëlqyer) e romanit.

Fjalë kyçe: viktorianizmi, shaoqëri borgjeze, shkencë, aristokraci, Revolucion industrial.

HYRJE

Mesin dhe gjysmën e dytë të shekullit 19-të anglezët zakonisht e quajnë “periudha viktoriane” (Victorian Age). Për ta fjala ‘viktoriane’ është bërë simbol jo vetëm për karakteristikat e letërsisë së asaj kohe, por edhe për tërë qytetërimin e atëhershëm britanik. Historianët e letërsisë dhe kulturës britanike janë të mendimit se kohëzgjatja e veçorive “viktoriane” nuk pajtohet tërësisht me kohëzgjatjen e sundimit të Mbretëreshës Viktoria (1837-1901),

meqë në fillim të viteve të 80-ta bie në sy një shembje e këtij sistemi relativisht stabil të vlerave dhe një depërtim i tendencave të reja.

Termi “viktorian/e” u krijua fill pas Luftës së Parë Botërore, kur intelijenca britanike pësoi tronditje dhe zhgënjim të madh nën ndikimin e asaj tronditjeje vigane që shkatërroi jo vetëm shumë jetë njerëzore dhe shumë vepra të krijuara nga dora njerëzore, por rrënoi edhe shumë ideale të cilat kanë qenë baza morale dhe ideologjike e periudhës viktoriane. Prandaj edhe ky term ka pasur ndonjëherë edhe domethënie negative, ndonse vlerat e letërsisë viktoriane tashmë janë rehabilituar. Ky term ka mbetur ende në përdorimin e përditshëm dhe nënkupton viktorianizmin në tërësi si një lloj periudhe të dominimit të “mikroborgjezisë”. Sipas bazës së saj materiale, e cila çdo shoqërie i jep karakteristikat më të rëndësishme, shoqëria britanike e periudhës viktoriane ishte zhvilluar mjaft në kuadrin e shoqërisë borgjeze.

TRUPI

Revolucioni industrial solli dhe konsolidoi sistemin e fabrikës dhe shtresën e re kapitaliste të shoqërisë, industrialistët, nga një anë, dhe klasën punëtore, nga ana tjetër, të cilat u bënë dy klasat dominuese të shoqërisë në kundërvënien të mprehtë ndaj njëra tjetrës. Pikërisht këto karakteristika të reja i dhanë shoqërisë britanike vullën vendimtare e cila deri atëherë kishte qenë një shoqëri hibride borgjeze-aristokratike. Ekonomia kapitaliste e Britanisë së Madhe ishte zhvilluar gjatë atyre pesëdhjetë viteve dhe kishte arritur kulmin, kështu që Britania a Madhe aso kohe ishte bërë fuqia e parë botërore, si në pikëpamje ekonomike ashtu edhe në pikëpamje politike. Ndërkohë Britania e Madhe ishte bërë perandoria koloniale më e madhe e botës Nëse qytetari i rëndomtë anglez tregonte kënaqësinë e tij që i takonte një kombi të tillë, dhe tregonte një lloj krenarie ishullore, këto nuk ishin të pabaza. Kjo vetëkënaqësi kombëtare është një ndër veçoritë esenciale të mentalitetit viktorian (Legouis, Cazamian faqe1087, 1091).

Për një shoqëri të tillë borgjeze, në hovin e zhvillimit të saj ka qenë karakteristik dhe zhvillimi i shpejtë i shkencës dhe i teknikës, gjë që ka ndikuar mjaft edhe në formimin e një ideologjie të re shoqërore. Veprimi i tillë ka qenë dytësor: nga një anë, ai krijoi një bindje optimiste se progresi, duke sjell rritje të përhershme të begatisë shoqërore, me kalimin e kohës do t'i zgjidhte të gjitha problemet dhe do të bënte të mundur formimin e federatës botërore qytetare dhe demokratike, ashtu si kishte parashikuar Tenisoni në poemën e tij “Lokëslli Holl”.

Kurse nga ana tjetër, kjo krijoi probleme për përshtatjen e imazhit të ri të botës dhe të vlerave. Në kuadrin e këtyre problemeve, për shoqërinë borgjeze angleze gjëja më e rëndësishme ishte problemi i përshtatjes së ideve dhe botëkuptimeve të trashëguara fetare me konceptet dhe vlerat shkencore, të cilat i goditën dhe i shembën në disa pika. Lidhur me këtë, ndikim më të madh patën rezultatet e kërkimeve biologjike të Darvinit. Një pjesë e madhe e shtresës sunduese britanike e anashkaloi konfliktin pak a shumë duke pranuar një zgjidhje spontane dhe kompromisi që në të vërtetë donte të thoshte praktikisht se ajo i miratonte arritjet shkencore ndërsa formalisht i mbeti besnike pikëpamjes religjioze mbi botën. Prandaj s'është për tu çuditur se feja po bëhej një formë gjithnjë e më e zbratur dhe se veprimtaria e saj po ngushtohej dhe përqëndrohej kryesisht për ruajtjen e ceremonive tradicionale dhe verbalisht pranonte disa parime ose rregulla fetare. Përveç këtij kompromisi, veçanërisht në qarqet e inteligjencës, debatohej edhe për pikëpamje të tjera, kontradiktore dhe ekstremiste.

Mirëpo, asnjëra prej këtyre ideologjive nuk ishte në gjendje t'i injoronte vlerat e deriatëhershme të shoqërisë angleze të asaj kohe apo vlerat viktoriane. Në këtë mënyrë, besimi në progres brenda kornizës së sistemit kapitalist dhe të demokracisë borgjeze, u shpreh përmes sistemeve ndikuese filozofike të **utilitarizmit** të Xh. Bentamit dhe të **pozitivizmit** të Xh. Millit dhe H. Spenserit. Paradoksi konsiston në faktin se këto sisteme nuk u pranuan tërësisht nga opinioni publik, ndonse praktika e vërtetë jetësore dhe shoqërore e shtresave sunduese përputhej me parimet e tyre kryesore. Pikërisht këtu bie në sy ajo hipokrizia e shoqërisë viktoriane e cila më vonë është konsideruar si veçori e saj negative. Përveç kësaj, në një rezistencë të madhe publike hasi Tomas Haksëlli me predikimin dhe përhapjen e pikëpamjeve darvinistike dhe agnostike mbi botën. Mirëpo botëkuptimet e intelegjencës, e më vonë edhe të shtresave të gjëra shoqërore, kishin marrë atë drejtim. Ekonomistët e shquar të kësaj periudhe (D. Rikardo dhe të tjerë), propagonin parimet kapitaliste liberale, duke konsideruar se ekonomia kapitaliste vet i rregullon dhe i avancoon çështjet e veta, prandaj ata ishin kundër ndërhyrjes së shtetit në ekonomi dhe në organizimin e sindikatave të punëtorëve. Teoritë e tilla pajtoheshin tërësisht me filozofinë utilitariste dhe pozitiviste. Këto krijojnë dhe formojnë aspektin esencial të pikëpamjes optimiste mbi botën.

Në përgjithësi gjatë tërë kësaj periudhe pati edhe reagime mbi pikëpamjet e ndryshme të inteligjencës. Disa aspekte të këtyre reagimeve kanë ushtruar ndikim ideologjik në letërsi. Sipas një rendi kronologjik, më parë duhet të përmendim Lëvizjen e Oksfordit (The Oxford Movement). Kjo ishte një rrymë fetare e intelektualëve me tendenca fetare të përqëndruar në Universitetin e Oksfordit, në vitet 30-të dhe 40-të të shekullit 19-të. Duke kuptuar se pikëpamja religjioze mbi botën nuk mund të përhapet aq lehtë, ata, përmes fjalimeve dhe polemikave në shtyp,

filluan fushatën për këndelljen apo ringjalljen e religjionit anglikan. Pikësynimi i tyre ishte para së gjithash përforsimi i veprimit emocional dhe religjioz mbi turmat, me fuqizimin dhe përforsimin e aspekteve emocionale dhe ceremoniale në praktikën fetare. Përfaqësuesi kryesor i kësaj lëvizjeje ishte Xhon H. Njumeni (1801-1890), i cili u dallua me prirjen e tij që ideologjinë e tij ta përhapte përmes veprimtarisë letrare. Ai ishte më konsequent se bashkëlufëtaret e tij dhe i dha fund veprimtarisë së tij në këtë lëvizje duke kaluar dhe duke u konvertuar në fenë katolike të Romës. Në këtë mënyrë, ai e diskreditoi dhe e humbi ndikimin e tij të udhëheqësit, meqë katolicizmi i Romës për shumë anglezë ishte pak a shumë i papranueshëm. Kështu kjo lëvizje u shemb nga kundërthëniet e veta dhe nga lëvizjet e tjera shoqërore.

Një ndikim shumë më të madh ushtroi Tomas Karajli (1795-1881). Karajli nga urrejta që kishte ndaj makinave, industrisë dhe industrialistëve, kaloi në anën e lëvizjes çartiste të punëtorëve, por ai filloi të profetizonte përhapjen e patriarkalizmit mesjetar, duke kërkuar që emocionet të jenë mbi arsyen, kurse ekonominë dhe politikën, si dhe rolin kryesor në shoqëri dhe histori, ta kishte heroi i tij. Kësaj lëvizjeje iu bashkua edhe një profet tjetër viktorian, Xhon Raskini. Si estet, kritik dhe historian i artit, Raskini u ngrit kundër “shëmtimit” të produkteve industriale dhe të ambientit të jetës borgjeze, të cilën e kishte krijuar industria dhe filloi të predikonte dhe të rekomandonte “bukurinë” në jetë dhe në punë. Por, ai e gjente bukurinë para së gjithash në format gotike të arkitekturës. Ky ishte një reagim ndaj artit zyrtar dhe akademik, i cili shëmbëlltyrat e tij i kërkonte në renesancë (Rilindje). Në këtë mënyrë, Raskini u gjet në anën e njëjtë si pjesëtarët e lëvizjes poetike dhe artistike. Ai po kështu u orvat të krijonte edhe një teori ekonomike që ishte një lloj utopie apo një lloj socializmi i zanatçijve. Përkundër të gjitha këtyre qëllimeve të mira dhe të një numri të mirë të eseve dhe vështrimeve që predikonin humanizmin, ideologjia e Raskinit nuk qe jetëgjatë. Mirëpo, disa nxënës dhe adhurues të tij si p.sh Uilliam Morrisi, vendosën të krijonin një lloj socializmi shkencor ndonse numri i tyre ishte i vogël. Një reagim të veçantë ndaj optimizmit borgjez bëri edhe Metthju Arnoldi (1822-88). Si kritik i shoqërisë, Arnoldi e sulmoi vetëkënaqësinë, izolimin ishullor dhe provincializmin, duke u ngritur edhe kundër “hebraizmit” apo moralit të mbështetur në pritjen e shpërblimit ose të dënimit, të trashëguar nga puritanizmi anglez, me ç’rast ai shfaqti përkrahjen e tij për “helenizmin”, humanizmin liberal të frymëzuar nga trashëgimia etike antike. Dhe ai bëri disa kompromise me krishtërimin, duke zgjedhur e pranuar disa parime morale që i pëlqenin atij. Agnosticizmi i tij u shoqërua me keqardhjen dhe nostalgjinë për besimin e humbur dhe për ato kohëra kur besimi sundonte shpirtat njerëzorë. Ky dualitet është ndoshta qëndrimi më tipik i intelektualëve viktorianë. Ndonse ka disa programe pozitive, Arnoldi ishte kryesisht pesimist sepse ai nuk mund t’i shihte të mirat e një shoqërie, prandaj për çdo gjë zgjodhi edhe epitete denigruese; kështu, arsitokracinë e quan “barbare”, borgjezinë e quan “filistine” (dyfytirëshe), kurse popullin e thjeshtë e quan “turme”.

Ky është një qëndrim tipik për shumicën dërmuese të intelektualëve evropianë të shek. 19-të dhe 20-të, apo më mirë të themi është një qëndrim i inteligjencës si të një shtrese ndërklasore që e vë veten mbi të gjitha klasat dhe mban ligjëratat për humanizmin si ndonjë “aristokraci shpirtorë”. Në tërësi, mund të themi se “viktorianizmi” është një kompleks ideologjik dhe karakteristik i borgjezisë angleze në epokën kur Anglia arriti pikën kulmore të fuqisë së saj.

Së këndejmi, si besimi optimist mbi progresin kapitalist ashtu edhe reagimet e ndryshme kritike dhe pesimiste për të janë njësoj pjesë përbërëse të këtij kompleksi viktorian, meqë kritikët paraqiteshin nga pozicionet e njëjta të një baze dhe asnjëri prej tyre nuk dyshonte në themelin e sistemit shoqëror. Kritika punëtorë dhe socialiste e shoqërisë, posa kishte filluar dhe nuk ishte aq e pranishme në opinionin publik, megjithëse lëvizja çartiste pa ndonjë ideologji të qartë dhe udhëheqësi të fortë, dëshmoi se çfarë fuqie mund të ketë turma ose masat e organizuar punëtorë. Natyrisht, çdo borgjezi kombëtare kishte edhe veçoritë e saj historike, kështu që edhe shoqëria britanike kishte veçoritë e saja, ndonse ato nuk ishin aq të mëdha sa të mund ta ndryshonin përkufizimin e kësaj epoke (Sampson, 760-764). Kështu, karakteristikat më të rëndësishme të kësaj periudhe mund t’i përcaktojmë shkurtimisht në këtë mënyrë: Së pari, borgjezia britanike pati si karakteristikë deri diku izolacionizmin dhe konservatizmin; së dyti, ende ndiheshin pasojat e karakterit të kompromisit borgjez dhe feudal të revolucionit qytetar britanik. Ndonse forma kapitaliste e ekonomisë kishte mbisunduar kaheerë, demokracia politike po përparonte mjaft ngadalë. Titujt dhe gjaku blu ende kishin autoritet dhe ndikim politik, megjithëse kishte kohë që kishin humbur epërsinë materiale dhe privilegjet. Kufijtë e një shoqërie dinjitoze të një xhentëlmeni ishin ende të rrepta dhe të ngushta, ndonse në krahasim me shekullin e 18-të, ato kufij ishin zgjeruar. Përveç aristokracisë dhe borgjezisë së vjetër tregtare dhe financiare, tani ishin të pranishme inteligjenca dhe intelektualët. Është interesantë se në një shoqëri të tillë nuk ishin përfshirë as punëtorët, as qytetarët dhe as industrialistët.

Një ndër karakteristikat e borgjezisë britanike ishte feja e saj protestane. Megjithëse feja e saj e kishte humbur përmbajtjen deri në njëfarë shkalle, ajo në atë kohë ende ruante të drejtën që të paraqitej si pikëpamja zyrtare ndaj botës. Ateizmi kishte mbetur tabu në opinionin publik (megjithëse kishte ateizëm spontan në mesin e punëtorëve), kurse agnosticizmi i disa intelektualëve mezi tolerohej. Lidhur me këtë, në opinionin publik kishte mbetur ende

ndikimi i madh i Mbretëreshës Viktoria, e cila ishte përfaqësuesja e mënyrës së jetës së shtresës sunduese dhe e moralit standard, veçanërisht sa i përket moralit të gjinive. Çdo paraqitje pak a shumë e hapur ose e tepruar e jetës seksuale në gazetari ose në letërsi ishte ende tabu, dhe në këtë periudhë nuk pati cenime të këtij qëndrimi (Albert, 366-369).

PERFUNDIME

Në fillim të punimit është dhënë një sqarim rreth termit dhe dukurisë “viktorian/e” që u krijua fill pas Luftës së Parë Botërore. Ky term ka mbetur ende në përdorimin e përditshëm dhe nënkupton viktorianizmin në tërësi si një lloj periudhe të dominimit të “mikroborgjezisë”. Revolucioni industrial solli dhe konsolidoi sistemin e fabrikës dhe shtresën e re kapitaliste të shoqërisë, industrialistët, nga një anë, dhe klasën punëtore, nga ana tjetër, të cilat u bënë dy klasat dominuese të shoqërisë në kundërvënien të mprehtë ndaj njëra tjetrës. Këto karakteristika të reja i dhanë shoqërisë britanike vulën vendimtare e cila deri atëherë kishte qenë një shoqëri hibride borgjeze-aristokratike. Në tërësi, mund të themi se “viktorianizmi” është një kompleks ideologjik dhe karakteristik i borgjezisë angleze në epokën kur Anglia arriti pikën kulmore të fuqisë së saj. Përveç aristokracisë dhe borgjezisë së vjetër tregtare dhe financiare, tani ishin të pranishme inteligjenca dhe intelektualët.

BIBLIOGRAFIA

- Adams, J. Eli. (2012). *A History of Victorian Literature*. Clichester West Cambridge.
- Albert, E. A. (1985). *History of English Literature*. Hong Kong.
- Altick, R. D. (1973). “*The Weaker Sex*”, *Victorian People and Ideas: A Companion for the Modern Reader of Victorian Literature*. New York: Norton.
- Anger, Suzy, Ed. (2001). *Knowing the Past: Victorian Literature and Culture*. London: Cornell UP.
- Carlyle, Thomas. (1840). *On Heroes, Hero-worship and the Heroic in History*. London: Robson and Sons, Printers, Pancras Road, N.W.
- Clarke, Waldo. (1976). *A Short History of English Literature, Evans Brothers*. Limited, Ibadon.
- Cruttendan, Aidan. (2003). *The Victorians, Facts and Files*. London.
- Daiches, David. (1963). *A Critical History of English Literature, Volume II*. London, Secker and Warburg.
- Damrosch, David Ed. (2003). *The Longman Anthology of British Literature*. New York, Addison Wesley Educational Publishers Inc.
- Higginbotham, Ann. (1992). *Sin of the Age, Infanticide and Illegitimacy in Victorian London*. Ohio UP.
- Hughes, Winifred. (1980). *The Maniac in the Cellar, Sensation Novels of the 1860*. Princeton UP.
- Legouis, Emilie. (1978). *A Shory History of English Literature*. The Clarendon Press, Oxford.
- Newton, Judith. (1981). *Women, Power and Subversion Social Strategies in British Fiction: 1778-1860*. Athentlis.
- Nield, Keith. (1973). *Prostitution in the Victorian Age*. Debates on the Issues from Nineteenth Century Critical Journals, London.
- Sampson, George. (1961). *The Concise Cambridge History of English Literature*. Second Edition, Cambridge, At the University Press.
- Sampson, George. (1961). *The Concise Cambridge History of English Literature*. Second Edition, Cambridge, At the University Press.